

VENDIM
Nr. 203, datë 5.4.2006

**PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT
TË OBJEKTEVE REPARTI, KOMANDA, PALESTRA DHE POLIGONI, TË
REPARTIT RENE, TIRANË, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE
MINISTRIA E DREJTËSISË**

(Ndryshuar me VKM nr. 1007, datë 10.12.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekteve “Komanda e repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 450 m² dhe numër rendor 4 “Palestër e repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 760 m² dhe numër rendor 5, “Poligon i repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 665 m² dhe numër rendor 3, si dhe trualli i objektit “Reparti Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 3406 m² dhe numër rendor 1, sipas formularit që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë për ndërtimin e mjediseve të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

2. Pronat me numër rendor 1, 3, 4 e 5 të hiqen nga lista e inventarit të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

(Shtuar me VKM nr. 1007, datë 10.12.2010)

1. . FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror MRP (Reparti Renea Tiranë)										
Bashkia/komuna Tiranë										
Fusha e përdorimit të pronës: ruajtje e rendit										
Nr · re nd	A			B			C			
	Zo na kad ast ind eks i i har tës	Nr. i pas uris ë	Emërtes a e pronës vendodhja/shtrirja gjeografike	Kompo nentët përbër ës të pronës	Adresa/ve ndndodhja e kompen tëve përbërës	Për mas at e pron ës në m ² ose ml	Funk sioni për të cilin përd oret pron a	Instituci oni/enti me përgjegj ësi adminis trative	Instituci oni/enti përdoru es statusi juridik i përdori mit	Të dhën a të tjera (shë nime të veça nta)
1	2	3	4	5.	6	7	8	9	10	11
1			Reparti Renea Rr.Jordan Misja Tiranë		Truall total Perëndim	8000				Ardhur me shkrësë nr.403 datë 13.7.2002
2				Fjetore	Rep.R.Perëndim	420	Fjetore	MRP	Reparti Renea	
3				Poligon	Rep.R.Jug	665	Poligon	MRP	Reparti Renea	
4				Komanda	Rep.R.Veriperëndim	450	Komanda	MRP	Reparti Renea	
5				Palestër	Rep.R.Veriperëndim	760	Palestër	MRP	Reparti Renea	
6				Palestër	Rep.Renea	144	Plestër	MRP	Reparti Renea	
			Parku aulo							
7				Garazhe	P.A. Lindje	540	Gara zhe	MRP	Reparti Renea	
8				Magazinë	P.A. Perëndim	126	Magazinë	MRP	Reparti Renea	
9				Kashun qeni	P.A. Veriperëndim	60	Kashun qeni	MRP	Reparti Renea	
1				Kashu	P.A. Veri-	48	Kash	MRP	Reparti	


[illegible]

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

FETAH HASANAJ



A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 8330, NR. PASURISË 7/102

INDEKSI I HARTËS TR-L-10

ADRESA E PASURISË: Rrethi - TIRANË, Q/ TIRANË

Rr JORDAN KISHA, P/G _____, Sh _____

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. _____

L. _____

J. _____

P. _____

D. Data: _____ / 2010, Ora _____, Punoi: _____

SHETET

